Nr: 1916 Prot
dt: 19. 05. 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**FAKULTETI EKONOMIK**

Nr. 600/1 Prot

Shkodër, më 19.05.2026

**Lënda: Përcjellje e miratimit të vendimit Nr.74, datë 11.05.206 të departamentit të Turizmit, për publikim.**

**REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**PROF. DR. TONIN GJURAJ**

Bashkëngjitur kësaj shkrese po ju përcjellim miratimin e vendimit Nr.74, datë 11.05.206 të departamentit të Turizmit, për publikim.

Kjo shkresë përpilohet në 3 (tre) ekzemplarë.

**DEKANI**

**Prof.as.dr.Eldiana Bashi**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - FAKULTETI EKONOMIK - UNIVERSITETI "LUIGJ GURAKUQI" SHKODËR

Kuratohet!

**R E P U B L I K A   E   S H Q I P Ë R I S Ë**
**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**
**FAKULTETI EKONOMIK**
**DEPARTAMENTI TURIZËM**

**Nr.** 600 **Prot** **Shkodër, më 12.05.2026**

**V E N D I M**
Nr.74 , datë 11.05.2026

**PËRCAKTIMI I TABELËS SË VLERËSIMIT ME PIKËZIM TË DOSJEVE TË APLIKANTËVE PËR PRANIM NË PROGRAMIN E DOKTORATËS "EKONOMI DHE TURIZËM I QËNDRUESHËM" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të Nenit 78 pika 2 e Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Standarti II.4 Kriteri 1 i VKM Nr. 824, datë 24.12.2021 e Kodit të Cilësisë; Nenit 11 pika 9 të Statutit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi"; të nenit 8 pika 8.3 e Rregullores Institucionale"Për Organizimin e Programit të Studimit të Ciklit të Tretë Doktoratë në UNISHK" me Vendimi S.A. nr.137 datë 28.04.2025 nr.1612 prot.datë 28.04.2025; Nenit 40 pika 2 e Rregullores së Fakultetit Ekonomik të USH; të Neni 29 pika 7,8 të Rregullores së Departamentit të Turizmit të FEUNISHK, Vendimit për Caktimin e Kritereve të Doktoratës '25-26, nr.66 datë 26.01.2026 Nr.129 datë 26.01.2026 i Departamentit të Turizmit; Vendimi i S.A. për caktimin e kritereve të doktoratës '25-26 Nr.128 datë 23.04.2026 nr.1549 prot. datë 23.04.2026, Asambleja e Departamentit të Turizmit, në mbledhjen e datës 11.05.2026, unanimisht,

**VENDOSI:**

1. Të përcatojë këtë tabelë të vlerësimit me pikëzim të dosjeve të aplikantëve për pranim në programin e Doktoratës "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm" për vitin akademik 2025-2026:

| **Emri mbiemri i aplikantit** | **Nota mesatare: 0.25 x për notën mesatare BACHELOR dhe 0.35 x** | **Vlerësimi i Projekt-Propozimit x 0.3:**<br><br>1)Përputhja e çështjes së zgjedhur si problem kërkimor më një nga projektet kërkimore-zhvillimore të Departamentit të Turizmit (0 – 10 pikë) | **Eksperienca akademike dhe kërkimore shkencore x 0.1 pikë:** | **Totali i pikëve:** |
|---|---|---|---|---|

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **për notën mesatare MASTER**<br><br>0.25 x mes.Bachelor<br>0.35x mes.Master | 2)Përdorimi i metodologjisë kërkimore dhe i instrumenteve të kërkimit (0- 5 pikë)<br><br>3)Origjinaliteti i punimit (0-5 pikë)<br><br>4)Dobia e punimit për zhvillimin e teorisë, për zbatimin prkatik, për studime të mëtejshme (0-10 pikë) | Për çdo vit 1 pikë | |
| 1...... | | | | |
| 2..... | | | | |

## Vlerësimi i prioriteteve:

1. Personeli akademik me kohë të plotë i FEUNISHK/Departamentin e Turizmit – 2 pikë/3 pikë
2. Personeli akademik me kohë të pjesshme i FEUNISHK/Departamentin e Turizmit – 1.9 pikë/2.9 pikë
3. Personeli akademik me kohë të plotë në Departamentet e Fakulteteve të tjera të USH – 1.5 pikë
4. Personeli akademik me kohë të pjesshme në Departamentet e Fakulteteve të tjera të USH – 1.2 pikë
5. Personeli akademik me kohë të plotë të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera publike dhe jo publike – 1.2 pikë
6. Personeli akademik me kohë të pjesshme të Fakulteteve Ekonomike të Universiteteve të tjera publike dhe jo publike – 1 pikë
7. Personeli akademik/kërkimor në Universitete të tjera dhe të institucioneve ose organizatave publike dhe jo publike që përfshihen në kërkimin bazë ose të zbatuar, aktiviteti i të cilave lidhet me fushat e kërkimit të Doktoraturës – 1 pikë

2. Ky vendim i përcillet Dekanit të FEUNISHK për miratim përfundimtar.

**Përgjegjëse e Departamentit të Turizmit**

**Prof.dr.Arjeta Troshani**